

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË



STATUTI  
I  
INSTITUTIT TE NDERTIMIT

HYRJE

Ky statut percakton menyren e veprimtarise se *Institutit te Ndertimit*, kompetencat e Organeve Drejtuese si dhe te drejtat dhe detyrat e punonjesve te tij.

E gjithë veprimtaria e ketij Instituti mbeshetet ne Ligjit Nr. 7582, dt. 13.07.1992 “*Për Ndërmarrjet Shtetërore*” me ndryshime si dhe ne Urdherin e Ministrit te Rregullimit te Territorit dhe Turizmit nr. 225, date 29.06.2004 “*Per Krijimin e Institutit te Ndertimit*” (IN).

**Neni 1**  
**Emertimi dhe Selia**

Me Urdher te Ministrit te Rregullimit te Territorit dhe Turizmit nr.225, date.29.06.2004 eshte krijuar **Instituti i Ndërtimit**.

Selia e tij eshte Rr. Myslym Keta Brar Tiranë.

## Neni 2

### Objekti i veprimtarisë

Objekti kryesor i punës së Institutit të Ndërtimit është kryerja e veprimtarive kërkimore, shkencore, aplikative, zhvillimore, studimore dhe projektuese në fushën e ndërtimit, si dhe kryerja e veprimtarive shkencore e teknologjike për të tretë të tilla si oponenca, ekspertiza, kurse kualifikimi, vlerësime konformiteti dhe kontrolle për produktet e ndërtimit që lidhen me sigurinë e jetës.

## Neni 3

### Kapitali themeltar

Kapitali Themeltar i IN-se është **26,151,674 leke**.

## Neni 4

### Organet Drejtuese

Organet drejtuese të IN-se janë:

- Këshilli Drejtues
- Drejtori i Përgjithshëm

## Neni 5

### Këshilli Drejtues.

1. Organi Drejtues i IN-se është Këshilli Drejtues (KD).
2. KD është organ kolegjal që realizon drejtimin e veprimtarisë së IN-se. Ai ushtron të drejtat dhe detyrat e tij duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi.
3. KD përbëhet nga 5 anëtarë. Anëtarët e KD dhe midis tyre Drejtori emërohet nga Ministri për një periudhë 4 vjeçare. Anëtarët e Këshillit Drejtues si rregull ushtrjnë edhe funksionet drejtuese teknike në ndërmarrje. Ministri ka edhe të drejtën e shkarkimit me një vendim të motivuar. Ato mund të riemërohen.
4. Pagat e anëtarëve të KD-se përcaktohen sipas dispozitave ligjore.
5. KD mbledhet sa here e kërkojnë interesat e IN-së, por si rregull jo më pak se 1 herë në muaj. Të drejtën e thirrjes së mbledhjes së tij e ka Drejtori i Përgjithshëm, ose me kërkesën e shumicës së anëtarëve të Këshillit.  
Rendi i ditës dhe materialet e mbledhjes i dërgohen zyrtarisht me shkrim ( Hard Copy) dhe me postë elektronike, anëtarëve të Këshillit Drejtues, jo më vonë se 2 ditë kalendrike para datës së përcaktuar për mbledhje. Çdo anëtar deklaron me shkrim adresat ku do t'iu dorëzohet dokumentacioni.
6. Mbledhja e KD-se quhet e rregullt vetëm kur **janë prezent** jo më pak se gjysma e anëtarëve të tij, dhe merr vendime kolegjiale me shumicë votash. Në rast se votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e drejtorit është përcaktuese.

7. KD miraton llogarite vjetore dhe raportin vjetor të veprimtarisë ekonomike e financiare të Institutit të Ndërtimit.
8. KD merr vendime për lidhjen e kontratave të huadhënies me subjekte shtetërore ose private.
9. KD merr vendime për zgjidhjen e nevojave sociale (fatkeqësi, sëmundje etj) të punonjësve të IN-se.
10. KD merr vendime për aprovimin e tarifave të analizave dhe shërbimeve të ndryshme që kryen IN-ja për llogari të te treteve, sipas propozimeve të bëra nga **Drejtoria**
11. Përcakton pagat e punonjësve, rritjen e tyre, shpërblimin suplementar të punonjësve në nivelin e shpërblimit të dietave për shërbimet brenda dhe jashtë vendit, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
12. KD përcakton kriteret e përgjithshme të marrjes në punë dhe të largimit nga puna të punonjësve në përputhje me ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”.
13. Vendos për shitjen dhe dhënien me qera të mjeteve kryesore të institutit në baze të dispozitave ligjore në fuqi.
14. Merr vendime për problemet sociale që lidhen me kushtet e përgjithshme të punës në IN.
15. KD harton Rregulloren e Brendshme të veprimtarisë së IN-se e cila hyn në fuqi pas dënies së pelqimit nga Ministri **pergjegjes**.
16. KD mban librin e vendimeve dhe proces-verbalet e mbledhjes, të cilat nënshkruhen nga të gjithë anëtarët. Një kopje e vendimeve të mbledhjes i dërgohet në mënyrë periodike, çdo muaj, jo më vonë se 5 ditë nga zhvillimi i mbledhjes nga organi i emëtuesës.
17. Shpërblimet suplementare mujore të anëtarëve të Këshillit Drejtues të cilët nuk janë punonjës të Institutit të Ndërtimit është 15% të pagës mujore të Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Ndërtimit

## **Neni 6 Drejtori i Përgjithshëm**

1. Drejton Institutin e Ndërtimit bazuar në ligjin nr. 7582 dt. 13.07.1992 “Për Ndërmarrjet Shtetërore” me ndryshime, si dhe aktet e tjera nënligjore.
2. Drejtori i Përgjithshëm i IN-se emërohet dhe lirohet nga detyra me Urdhër të Ministrit **pergjegjes**.
3. Paraqet periodikisht dhe detyrimisht në mbyllje të çdo viti raportin për veprimtarinë ekonomike dhe financiare të IN-se në KD dhe pas miratimit të tij ky raport i dërgohet ministrisë **pergjegjese** dhe organeve shtetërore përkatëse.
4. Përfaqëson IN-ne në të gjitha marrëdhëniet juridike dhe administrative para organeve shtetërore, organeve homologe brenda e jashtë shtetit, ose autorizon punonjës të tjerë për ta përfaqësuar atë.

5. Organizon veprimtarinë e përditshme të IN-se, kontrollon realizimin e detyrave sipas programeve të punës të programuara ose të veçanta, të miratuara prej tij, në ndihmë të veprimtarisë së IN-se.
6. Gjatë ushtrimit të funksionit të tij, nxjerr Urdhër dhe Udhëzime në përputhje me legjislacionin në fuqi.
7. Miraton programet e punës së IN-se dhe kontrollon zbatimin e tyre.
8. Organizon analiza të punës të programuara ose të veçanta për veprimtarinë e strukturave të IN-se.
9. Kryen dhe organizon grupe kontrolli të planifikuara ose të befasishme aty ku ushtron veprimtarinë në zbatim të ligjit.
10. Analizon dhe kthen përgjigje brenda 10 ditëve ndaj ankesave dhe sugjerimeve të paraqitura nga punonjësit e IN-se.
11. Kontrollon përdorimin e kohës së punës, cilësinë e materialeve të përgatitura dhe zbatimin e kodit etikë – moral nga punonjësit.
12. Ben dhe miraton vlerësimin e punës për secilin punonjës dhe sipas rastit i propozon Këshillit Drejtues për shpërblime ose merr masa disiplinore ndaj tyre sipas Kodit të Punës.
13. Organizon punën për zbatimin e rregullave në përdorimin e mjeteve financiare.
14. Përgatit bilancin e të ardhurave e shpenzimeve të IN, programet e zhvillimit ekonomik – financiar të tij dhe pas aprovimit nga KD, ia paraqet Ministrisë **pergjegjese** për miratim.
15. Përgatit ndryshimet në strukturën organizative të IN-se, të cilën e kalon për miratim në Këshill Drejtues.
16. Negocion me organet drejtuese të Ministrisë **pergjegjese** dhe ngre grupe pune në zbatim të programit të kësaj ministrie dhe Qeverisë Shqiptare në lidhje me Projektet Zhvillimore në fushën e ndërtimit.
17. Drejton punën Kërkimore - Shkencore në IN.

#### **Neni 7**

#### **Eksperti Kontabël i Autorizuar.**

Kontrolli i Bilancit Financiar të IN-se ushtrohet nga një Ekspert Kontabël i Autorizuar, i cili percaktohet nga Ministria **pergjegjese**.

Pas kontrollit, eksperti kontabël i autorizuar, harton raportin përkatës konform ligjit. Ky raport i dorëzohet Organeve Drejtuese të IN-se, dhe i bashkëngjitet Raportit Vjetor që dërgohet pranë Ministrisë **pergjegjese**.

#### **Neni 8**

#### **Ushtrimi Financiar**

Ushtrimi Financiar fillon në 01 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti. Ushtrimi i pare financiar përfshin kohën nga data e Regjistrimit Tregtar deri më 31

Dhjetor te vitit te regjistrimit. Llogarite financiare mbahen nga Sektori i Financës, e cila mban te gjitha dokumentet përkatëse qe i nevojiten.

### **Neni 9 Llogarite vjetore.**

IN-ja nëpërmjet Drejtorise se Shërbimeve Mbështetëse dhe Financës do te mbaje kontabilitet te rregullt te pasurisë dhe veprimtarisë se saj ne pajtim me kërkesat ligjore. Ne mbylljen e ushtrimit, Drejtori i Përgjithshëm ngarkon Drejtorine e Shërbimeve Mbështetëse dhe Financës qe te hartoje inventarin e pasurisë dhe llogarite vjetore për ushtrimin financiar dhe raportin përkatës te administrimit për gjendjen e IN-se gjate ushtrimit financiar.

Ky raport pasi miratohet nga Keshilli Drejtues i IN iu behet i njohur edhe punonjësve te IN-se gjate analizës vjetore te punës dhe i përcillet Ministrisë **pergjegjese** për miratim.

Llogarite vjetore te IN verifikohen dhe vertetohen nga kontrollore te jashtem, te cilet caktohen per nje periudhe 4 vjecare nga Ministri **pergjegjes**. Keto llogari brenda afatit ligjor u dergohen strukturave pergjegjese.

### **Neni 10 Administrimi i te ardhurave.**

IN e përdor vete shumen e fitimit te realizuar nga vete ai pas zbritjes se tatimit, për qëllimet e përcaktuara ne piken 1 te nenit 11 te ligjit 7582 date 13.07.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore” si me poshtë:

- Për krijimin e rezervës se kapitalit;
- Për krijimin e rezervës për zhvillim;
- Për krijimin e rezervës për ndihma sociale;
- Për krijimin e rezervës për shpërblim suplementar te punonjësve;
- Për krijimin e rezervave te tjera.

Shteti nuk tërheq nga IN-ja pjese te fitimit te realizuar përveç detyrimit qe rrjedh nga legjislacioni tatimor.

### **Neni 11 Rezerva e Kapitalit.**

Rezerva e kapitalit në IN krijohet çdo vit deri sa shuma e saj të arrijë jo më pak se një e dhjeta e shumës së kapitalit. Ajo llogaritet jo më pak se 5 për qind mbi shumën e fitimit vjetor, që mbetet pas zbritjes të humbjeve të mbartura nga viti ose vitet pasardhëse, nëse ka të tilla humbje.

**Neni 12**  
**Rezerva për shpërblime suplementare.**

Rezerva për shpërblime suplementare e punonjësve llogaritet mbi te njëjtën shume te fitimeve si ne nenin 12 te ligjit “Për Ndërmarrjet Shtetërore” dhe jo me shume se 15 %.

IN mund te shpërndajë shpërblime suplementare për punonjësit vetëm kur disponon rezervën përkatëse dhe në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

**Neni 13**  
**Bashkimi, Ndarja ose Likuidimi.**

Bashkimin ose ndarjen e IN-se mund ta vendose Ministria **Pergjegjese**, pas propozimit ose konsultave me Këshillin Drejtues te IN-se. Ne rast falimentimi, likuidimi i IN-se behet ne përputhje me ligjin “Për falimentimin”. Ne këtë rast te gjitha tepricat e mbetura pas likuidimit i kthehen shtetit.

**Ing. Agron HYSENLLIU**  
**DREJTOR I PERGJITHSHEM**